



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

**PLANI I PUNËS
PËR VITIN 2021**

1. HYRJE

Komuna e Podujevës gjendet në veri-lindje të Kosovës. Podujeva posedon sipërfaqe prej 633.86 km² (5.8% të sipërfaqes së Republikës së Kosovës). Në aspektin e pozitës gjeografike, komuna e Podujevës shtrihet në Luginën e lumbrit Llap dhe ofron kushte të mira për kultura të ndryshme bujqësore. Ajo kufizohet me pesë komuna tjera të Republikës Kosovës (Prishtinë, Vushtrri, Mitrovicë, Obiliq, dhe Leposaviq). Nisur nga këta faktorë dhe nga kushtet e përshtatshme klimatike, bujqësia përfaqëson një potential te madh zhvillimi për ekonominë e komunës.

Në Komunën e Podujevës kultivohen kultura të ndryshme bujqësore, pemët e imëta (Mjedra, Aronia, Boronica, Dredhëza etj), bimët mjekësore dhe aromatike konsiderohen si kultura strategjike për krijimin e vendeve të reja të punës.

2. VIZIONI

Podujeva qendër e prodhimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore sidomos pemëve të imta cilësore për Kosovën, rajonin dhe më gjërë.

3. MISIONI

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë i harmonizuar sipas standardeve dhe praktikave të BE-së duke respektuar Politikat e Zhvillimit Rural (PZHR) të BE-së, normat ekologjike dhe konkurruese me vendet e rajonit dhe i mbështetur nga fondet zhvillimore lokale, qeveritare dhe ndërkombëtare.

4. OBJEKTIVAT E PËRGJITHME:

- Edukimi i vazhdueshëm / Përcjellja e inovacioneve në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural.
- Forcimi i zinxhirit ushqimor, mbrojtja e kafshëve dhe menaxhimi i rrezikut në bujqësi.
- Përfshirja sociale, zvogëlimi i varfërisë dhe zhvillimi ekonomik në viset rurale.
- Mbështetja institucionale në riaktivizimin e fermave, plantacioneve bujqësore dhe kapaciteteve përpunuese ushqimore në komunën e Podujevës.
- Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe rritje të sipërfaqeve punuese me sistem të ujitjes në funksion të rritjes së rendimentit.
- Mbështetja e zhvillimit ekonomik të komunës përmes nxitjes së investimeve në fushat:
 - ❖ Pemëtari duke përfshirë pemët e imta (mjedra, dredhëza, manaferra, boronica dhe aronia).
 - ❖ Perimtari
 - ❖ Lavërtari
 - ❖ Blektori
 - ❖ Vreshtari
 - ❖ Bletari, dhe
 - ❖ Produktet e veçanta (kërpudha, bimë medicinale dhe aromatike, kërmijtë, etj.).

5. OBJEKTIVAT SPECIFIKE (2021):

- Sektori pemëtarisë: Ngritje të pemishteve moderne me mjedër për 50 fermer me nga 1600 fidane.
- Sektori i perimtarisë: Ngritje të kapaciteteve të kultivimit të perimeve në ambiente të mbyllura (serra) me sipërsaqe prej 50 m^2 për 250 fermer.
- Sektori i bletarisë: Rritje të kapaciteteve prodhuese për Bletarët, ndarja e shoqërive të bletëve për 105 përfitues me nga 5 shoqëri bletësh dhe koshere tre katëshe antivaro.
- Sektori i blegtorisë: Rritje të kapaciteteve prodhuese për Blegtorët, ndarja e mëshqerrave për 70 përfitues.
- Subvencione për fermerët e dëmtuar.
- Pasurimi i qytetit, parqeve dhe hapësirave shkollore me drunjë dekorativ.
- Promovimi i sektorit të bujqësisë në Kosovë dhe në komunën e Podujevës përmes organizimit të aktiviteteve promovuese (Ditët e Agrobiznesit, Dita e eksportit të perimeve, pjesëmarrje në panaire, Dita e mjedrës, Dita e Mjaltit, etj.)
- Mbështetja e përpunuesve lokal përmes krijimit të lidhjeve me investitorët potencial.

6. SKEMA E SUBVENCIONEVE 2021

- Sektori i Pemëtarisë:

Vlera e Projektit: 56,000.00 €

Koha e realizimit - Prill, Maj

- Sektori i Perimtarisë:

Vlera e Projektit: 117,000.00 € (me bashkëfinancim 30%)

Koha e realizimit – Maj, Qershori

- Sektori i Bletarisë:

Vlera e Projektit: 56,000.00 € (me bashkëfinancim 30%)

Koha e realizimit - Maj, Qershori

- Sektori i Blegtorisë:

Vlera e Projektit: 122,200.00 € (me bashkëfinancim 30%)

Koha e realizimit - Qershori, Korrik

- Subvencione për fermerët e dëmtuar:

Vlera e Projektit: 76,350.00 €

Koha e realizimit - Shtator, Nëntor

- Pasurimi i qytetit, parqeve dhe hapësirave shkollore me drunjë dekorativ.

Vlera e Projektit: 100,000.00 €

Koha e realizimit – Prill, Maj

- Të tjera...

7. PROJEKTET NË BASHKËPUNIM ME MINISTRINË E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

- Subvencionet e MBPZHR-së për pagesa direkte, dhe thirrje të tjera për përkrahje të fermerëve.

DBPZHR bazuar në kriteret e MBPZHR-së do të vazhdoj në mbështetjen e fermerëve të komunës së Podujevës në përgatitjen e dokumentacionit të duhur për aplikimin e tyre on-line në këto skema si dhe në përcjelljen e tyre në MBPZHR për shqyrtim dhe miratim. Ky aktivitet zbatohet gjatë gjithë vitit kalendarik dhe është i ndarë sipas thirrjeve të MBPZHR-se për sektorët përkatës.

8. NGRITJA E KAPACITETEVE, PROMOVIMI SEKTORIT DHE GJETJA E FONDEVE SHTESË:

Në kuadër të rritjes së vlerës së fondeve të komunës për sektorin e bujqësisë, DBPZHR do të bashkëpunoj ngushtë me donatorë të ndryshëm potencial me qëllim të realizimit të projekteve që janë me rëndësi për zhvillimin e këtij sektori në komunën tonë.

- DBPZHR do të bashkëpunon me të gjithë fermerët me qëllim të monitorimit të projekteve të realizuara në të kaluarën dhe nxjerrjen e mësimeve.
- DBPZHR do të vazhdoj me seminare, trajnime dhe këshilla praktike për fermerët.
- Përgatitja dhe shtypja e materialeve edukative (libra, fletushka, fletëpalosje, etj.) për sektorin e bujqësisë që i dedikohet fermerëve, shoqatave të fermerëve dhe kooperativave bujqësore.

- DBPZHR do të përpiloj planin e mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore si dhe do të krijojë komisionet e duhura për këto aktivitete.
- DBPZHR do të përpiloj planin e korrje-shirjeve dhe do të krijon komisionin e monitorimit të korrje-shirjeve për sezonën 2021.
- DBPZHR do të përcjellë dhe monitoroj me kujdes gjendjen e prodhimtarisë pemtare dhe perimtare në komunë, do të jep rekomandimet e nevojshme.
- DBPZHR do të mirëmbaj rregullisht Ueb-faqen e komunës, duke pasqyruar aty tërë aktivitetin e vet me të dhëna të ndryshme, duke komunikuar me fermerët dhe publikun e interesuar, duke plasuar këshilla për fermerët, rekomandime dhe informata të rëndësishme për publikun.
- DBPZHR do të vazhdoj me praktikën e involvimit te shoqërisë civile/ekspertëve të pavarur dhe studentëve, përmes pjesëmarrjes aktive të tyre në proceset e vlerësimit në ndarjen e subvencioneve.
- DBPZHR do të inkurajon shoqatat bujqësore, ekspertët e bujqësisë dhe studentët në pjesëmarrjen e aktive të tyre në projektet e DBPZHR-së duke i angazhuar në aktivitetet e implementimit të projekteve.
- Aplikimi në skemat e programit IPA të BE-së për Kosovën (EURED, Rural grants) në bashkëpjesëmarrje me fermerët, shoqatat e fermerëve, kooperativat bujqësore, bizneset në sektorin e bujqësisë, etj.
- Aplikimi në skemat qeveritare për mbështetjen e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit ekonomikë (MAPL, MTI, MBPZHR, etj.)
- Aplikimi me projekte tek donatoret prezent në Kosovë (USAID, IADK, etj.)
- Aplikimi tek donatorët dhe fondacionet Kosovare prezent në Kosovë (CDF, MDA, etj.)

9. SEKTORI I PYLLTARISË:

- DBPZHR do të bashkëpunoj ngushtë me Agjencionin e Pyjeve të Kosovës dhe do të zbatoj me përpikëri politikat e sektorit.
- DBPZHR do të punoj edhe më tutje në stabilizimin e gjendjes në këtë sektor.
Do të angazhohet maksimalisht që të zvogëlohen në minimum:
 - ❖ Prerjet ilegale.
 - ❖ Të luftohen sëmundjet e ndryshme, dhe
 - ❖ Të evitohen dhe pengohen zjarret pyjore.
- DBPZHR do të intensifikoj dhënien e shërbimeve qytetarëve që bëjnë shfrytëzimin e assortimenteve drusore në mënyrë legale – leja për prerje në pyjet private.
- DBPZHR do të punoj në zbatimin e projekteve për pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura etj.
- Sektori i pylltarisë do të raporton në baza mujore tek Agjencionin i Pyjeve të Kosovës për:
 - ❖ Dinamiken e konfiskimeve mujore.
 - ❖ Specifikacionin e konfiskimeve.
 - ❖ Raportet e punëve të kryera në pyjet private.
 - ❖ Raportet e fletëparaqitjeve në gjykatë.
 - ❖ Raportet financiare të pagesave për pyjet private dhe publike, dhe
 - ❖ Dinamikën e prodhimtarisë sipas planit vjetor të Agjencionit të Pyjeve të Kosovës.
 - ❖ Aktivitete të tjera të po kësaj fushe.

10. AKTIVITETET TJERA:

- DBPZHR do të pranoj dhe shqyrtoj të gjitha kërkesat e fermerëve, shoqatave dhe kooperativave bujqësore, bizneseve që merren me sektorin e bujqësisë dhe akterëve tjerë të involuar në sektorin e bujqësisë, sipas specifikave të tyre të listuara më poshtë:
- ❖ Kërkesa për regjistrimin me Numrin Identifikues të Fermerit (NIF).
 - ❖ Kërkesa për shndërrimin apo ndërrimin e destinimit të tokave.
 - ❖ Kërkesa për nevoja të identifikimit të fermerëve në kuadër të aplikimeve për viza.
 - ❖ Kërkesa për subvencione.
 - ❖ Kërkesa për investime kapitale.
 - ❖ Kërkesa për shpalljen e ankandeve publike që ndërlidhen me sektorin e bujqësisë.
 - ❖ Kërkesa për vlerësimin e dëmeve në bujqësi nga fatkeqësitë natyrore.
 - ❖ Kërkesa të ndryshme.

Podujevë, Janar 2021

Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

